



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2181/6 prot.

Datë 24.09.2025

V E N D I M
Nr. 1325/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.09.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “A&E Engineering” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-52046-06-23-2025, me objekt: “*Mbikqyrja e punimeve për 4 objekte të infrastrukturës pubike për vitin 2025*”, me fond limit: 4,671,358.41 (katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2025, miratuar me VKB Nr.26, datë 03.04.2025, për një ndryshim në VKB Nr.131, Date 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025, **lotit III: REF-52058-06-23-2025**, Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10”, me fond limit: 1,248,778.49 (një milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë dyzet e nëntë) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Ankimues:	Operatori ekonomik "A&E Engineering" SHPK me NIPT K72113010E dhe adresë Rruga Mujo Ulqinaku, Objekti Nr.23, Z.1, Tiranë.
Autoriteti Kontraktor:	Bashkia e Tiranës me adresë Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 " <i>Për Prokurimin Publik</i> ", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 " <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 " <i>Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik</i> ", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 " <i>Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19</i> ".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

1.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik animues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.06.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-52046-06-23-2025, me objekt: “*Mbikqyrja e punimeve për 4 objekte të infrastrukturës pubike për vitin 2025*”, me fond limit: 4,671,358.41 (katër milion e gjashëqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH me burim financimi të *ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2025*, miratuar me VKB Nr.26, datë 03.04.2025, për një ndryshim në VKB Nr.131, Datë 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025, **lotit III: REF-52058-06-23-2025**, Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10”, me fond limit: 1,248,778.49 (një milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e shtatëdhjetë e tetë pikë dyzet e nëntë) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

II.2. Në datën 04.07.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 10.07.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BOE "STATENG" shpk & "MCE" shpk	960,108.81	I Skualifikuar
"A & E ENGINEERING" shpk	1,100,344.87	I Skualifikuar
BOE "Bersant Ylli" & "MAGNA CHARTA" shpk	1,100,344.87	I Skualifikuar
BOE "HYDRO-ENG CONSULTING" shpk &		
“BN PROJECT” shpk	1,100,344.87	I Skualifikuar
“NOVATECH STUDIO” shpk	1,100,344.87	I Skualifikuar
BOE “TESLA VIZION” shpk &		
“IMES-D” shpk	1,100,344.87	I Skualifikuar
"DERBI-E" shpk	1,101,578.75	I Skualifikuar
"TAULANT" shpk	1,101,687.13	I Skualifikuar
“TOËER” shpk	1,101,769.04	I Skualifikuar
“G B Civil Engineering” shpk	1,103,571.69	I Skualifikuar
"NET-GROUP" shpk	1,108,374.25	I Skualifikuar
"INFRATECH" shpk	1,115,137.87	I Kualifikuar

"M.A.K Studio" shpk	1,161,300	I Kualifikuar
"ZENIT&CO" shpk	1,223,802.92	I Kualifikuar

II.4. Në datën 11.08.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE "Formular Njoftim -Fituesi Paraprak", për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur OE "INFRATECH" SHPK, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 44, datë 18.08.2025.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/5667, datë 12.08.2025 dhe me Nr. 2181/2025 Prot., datë 12.08.2025 e operatorit ekonomik "A&E Engineering" SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "A&E Engineering" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2181/1 prot., datë 12.08.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "A&E Engineering" SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 2181/2 prot., datë 12.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, Bshkisë Tiranë, duke i kërkuar informacion, mbi vendimin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "A&E Engineering" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 32096 prot., datë 19.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2181/3 prot., datë 24.09.2025, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "A&E Engineering" SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "A&E Engineering" SHPK, duke argumentuar si më poshtë vijon: [...]

Operatori ekonomik "A&E Engineering" sh.p.k, në cilësinë e palës ankimuese ka paraqitur formularin e ankesës në bazën elektronike të të dhënave të KKP-së, në lidhje me skualifikimin e tij gjatë procesit të vlerësimit të ofertave për procedurën referuar si më poshtë:

KONSTATON DHE ARSYETON

Pala ankimuese "A&E Engineering" sh.p.k ngrenë pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

"Pretendojme që Autoriteti Kontraktor ka bërë një vlerësim të padrejtë, duke refuzuar ofertën tonë me pretendimin që "Operatori ekonomik "A&E ENGINEERING" shpk nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojca 9, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta për kualifikim ku përcaktohet: "Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të APP "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të 3 specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", pasi vlera e ofertës është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi sipas VKM nr.354 date 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim". AK është në shkelje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Ne i jemi referuar VKM nr. 354 date 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim" në përlllogaritjen e ofertes sone."

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) pas administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit vëren:

Në dokumentat standarte të tenderit të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, për "Loti III: Mbikëqyrja e punimeve për objektin "Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10", përcaktohet se:

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Në lidhje me pretendimin e ankimuesit KSHA, mori në shqyrtim procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave datë 10.07.2025, pjesë e të cilit është edhe Përcaktimi i Vlerës së Mbikëqyrjes për lotin III të objektit "Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10".

Nga shqyrtimi i procesverbalit të shqyrtimit dhe vleresimit të ofertave, konkretisht Përcaktimit të Vlerës së Mbikëqyrjes për lotin III të objektit “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10” ardhur me email-in e datës 09.07.2025, vlera e përlogaritur e mbikëqyrjes është si më poshtë:

Mbikëqyrje Max= 1,498,534.19 Lekë me tvsh Mbikëqyrje Max= 1,248,778.49 Lekë pa tvsh

Mbikëqyrje Min= 1,338,165.44 Lekë me tvsh Mbikëqyrje Min= 1,115,137.87 Lekë pa tvsh

Referuar përcaktimit të vlerës së mbikqyrjes, KSHA vendosi të bërë verifikimin e vlerës së përlogaritur të mbikëqyrjes, duke e ribërë përlogaritjen e vlerës së mbikqyrjes, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Mbeshtetur në VKM 354, datë 11.05.2016, Seksioni IV “Strukturat e Transportit dhe Qarkullimit”, përkatësisht në Nenin 44, Tabela e tarifave për shërbimet në lidhje me strukturat e transportit, për vlerën 129,072,712.42 Lekë pa TVSH, referuar natyrës së investimit, pranojmë Grupin e III Tarifor, me vlerat si më poshtë sipas tabelës 12, Tabela shoqëruese e tarifave, Strukturat e Transportit (Qarkullimit).

Vlerat referuese pa tvsh	Koficienti min	Koficienti max
105,000,000	3.71	4.21
140,000,000	3.31	3.75

Vlera e preventivit është **129,072,712.42 leke pa tvsh.**

Koeficientet e mesatarizuar janë si më poshtë:

Koficienti min K1 = 3.41

Koficienti max K2 = 3.87

Nga llogaritjet rezulton se vlera e mbikqyrjes është:

Mbikqyrje. Maximum = 1 498 534,19 Lekë me TVSH.

Mbikqyrje. Maximum = 1 248 778,49 Lekë pa TVSH

Mbikqyrje. Minimum = 1 320 413,84 Lekë me TVSH.

Mbikqyrje. Minimum = 1 100 344,87 Lekë pa TVSH

Për sa më lart shihet, KSHA konstaton se është bërë një lapsus në llogaritjen e vlerës miniale të mbikqyrjes së objektit “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10”, konkretisht vlerat e sakta janë si më poshtë vijon:

Mbikqyrje. Maximum = 1 498 534,19 Lekë me TVSH.

Mbikqyrje. Maximum = 1 248 778,49 Lekë pa TVSH

Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Mbikqyrje. Minimum = 1 320 413,84 Lekë me TVSH.

Mbikqyrje. Minimum = 1 100 344,87 Lekë pa TVSH

Përsa i përket Operatorit Ekonomik ankimues "A&E Engineering" sh.p.k, vlera që ky operator ka paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik është **1,100,344.87 lekë pa TVSH.**

Bazuar në nenet 36, 77 të ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, dhe pikës 2, të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe bazë VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", Rekomandimit të APP nr. 5585 prot., datë 25.07.2017 "Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016", si dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, **KSHA vlerëson se, në bazë të pikës 1, të nenit 1 të VKM Nr.354 datë 11.05.2016** parashikohet se *"Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e planifikimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës), të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali."*, **pikës 1 të nenit 7** parashikohet se *"Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik"*.

Sa më sipër, KSHA konstatoi se vlera prej 1,100,344.87 lekë pa tvsh, e ofertuar nga Operatori Ekonomik "A&E Engineering" sh.p.k është e njëjtë me vlerën minimale të përlllogaritur për vlerën e mbikëqyrjes, 1,100,344.87 lekë pa tvsh, vlerë të cilën KSHA e përlllogariti sipas parashikimeve të VKM Nr. 354 datë 11.05.2016, për procedurën e prokurimit me objekt: Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin "Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10".

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Ne bazë pikës 3, të nenit 114 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pikës 2 dhe 4 të nenit 100 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, **Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "A&E Engineering" shpk** për procedurën e prokurimit me objekt: *"Lotit III, Mbikqyrja e punimeve për objektin "Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10"*, me nr. REF-52058-06-23-2025, zhvilluar nga AK, Bashkia Tiranë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur të saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “A&E Engineering” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 32096 prot., datë 19.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2181/3 prot., datë 24.09.2025, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK.

III.1.2. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK, duke argumentuar si më poshtë vijon: [...]

Operatori ekonomik "A&E Engineering" sh.p.k, në cilësinë e palës ankimuese ka paraqitur formularin e ankesës në bazën elektronike të të dhënave të KKP-së, në lidhje me skualifikimin e tij gjatë procesit të vlerësimit të ofertave për procedurën referuar si më poshtë:

KONSTATON DHE ARSYETON

Pala ankimuese "A&E Engineering" sh.p.k ngrenë pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

"Pretendojme që Autoriteti Kontraktor ka bërë një vlerësim të padrejtë, duke refuzuar ofertën tonë me pretendimin që "Operatori ekonomik "A&E ENGINEERING" shpk nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojca 9, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta për kualifikim ku përcaktohet: "Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të APP "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të 3 specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", pasi vlera e ofertës është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi sipas VKM nr.354 date 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim". AK është në shkelje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Ne i jemi referuar VKM nr. 354 date 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim" në përlllogaritjen e ofertes sone."

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) pas administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit vëren:

Në dokumentat standarte të tenderit të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, për "Loti III: Mbikëqyrja e punimeve për objektin "Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10", përcaktohet se:

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Në lidhje me pretendimin e ankimuesit KSHA, mori në shqyrtim procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave datë 10.07.2025, pjesë e të cilit është edhe Përcaktimi i Vlerës së Mbikëqyrjes për lotin III të objektit "Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10".

Nga shqyrtimi i procesverbalit të shqyrtimit dhe vleresimit të ofertave, konkretisht Përcaktimit të Vlerës së Mbikëqyrjes për lotin III të objektit “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10” ardhur me email-in e datës 09.07.2025, vlera e përlogaritur e mbikëqyrjes është si më poshtë:

Mbikëqyrje Max= 1,498,534.19 Lekë me tvsh Mbikëqyrje Max= 1,248,778.49 Lekë pa tvsh

Mbikëqyrje Min= 1,338,165.44 Lekë me tvsh Mbikëqyrje Min= 1,115,137.87 Lekë pa tvsh

Referuar përcaktimit të vlerës së mbikqyrjes, KSHA vendosi të bërë verifikimin e vlerës së përlogaritur të mbikëqyrjes, duke e ribërë përlogaritjen e vlerës së mbikqyrjes, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Mbeshtetur në VKM 354, datë 11.05.2016, Seksioni IV “Strukturat e Transportit dhe Qarkullimit”, përkatësisht në Nenin 44, Tabela e tarifave për shërbimet në lidhje me strukturat e transportit, për vlerën 129,072,712.42 Lekë pa TVSH, referuar natyrës së investimit, pranojmë Grupin e III Tarifor, me vlerat si më poshtë sipas tabelës 12, Tabela shoqëruese e tarifave, Strukturat e Transportit (Qarkullimit).

Vlerat referuese pa tvsh	Koficienti min	Koficienti max
105,000,000	3.71	4.21
140,000,000	3.31	3.75

Vlera e preventivit është **129,072,712.42 leke pa tvsh.**

Koeficientet e mesatarizuar janë si më poshtë:

Koficienti min K1 = 3.41

Koficienti max K2 = 3.87

Nga llogaritjet rezulton se vlera e mbikqyrjes është:

Mbikqyrje. Maximum = 1 498 534,19 Lekë me TVSH.

Mbikqyrje. Maximum = 1 248 778,49 Lekë pa TVSH

Mbikqyrje. Minimum = 1 320 413,84 Lekë me TVSH.

Mbikqyrje. Minimum = 1 100 344,87 Lekë pa TVSH

Për sa më lart shihet, KSHA konstaton se është bërë një lapsus në llogaritjen e vlerës miniale të mbikqyrjes së objektit “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10”, konkretisht vlerat e sakta janë si më poshtë vijon:

Mbikqyrje. Maximum = 1 498 534,19 Lekë me TVSH.

Mbikqyrje. Maximum = 1 248 778,49 Lekë pa TVSH

Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Mbikqyrje. Minimum = 1 320 413,84 Lekë me TVSH.

Mbikqyrje. Minimum = 1 100 344,87 Lekë pa TVSH

Përsa i përket Operatorit Ekonomik ankimes "A&E Engineering" sh.p.k, vlera që ky operator ka paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik është **1,100,344.87 lekë pa TVSH.**

Bazuar në nenet 36, 77 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, dhe pikës 2, të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe bazë VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", Rekomandimit të APP nr. 5585 prot., datë 25.07.2017 "Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016", si dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, **KSHA vlerëson se, në bazë të pikës 1, të nenit 1 të VKM Nr.354 datë 11.05.2016** parashikohet se *"Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e planifikimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës), të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali."*, **pikës 1 të nenit 7** parashikohet se *"Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik"*.

Sa më sipër, KSHA konstatoi se vlera prej 1,100,344.87 lekë pa tvsh, e ofertuar nga Operatori Ekonomik "A&E Engineering" sh.p.k është e njëjtë me vlerën minimale të përlogaritur për vlerën e mbikëqyrjes, 1,100,344.87 lekë pa tvsh, vlerë të cilën KSHA e përlogariti sipas parashikimeve të VKM Nr. 354 datë 11.05.2016, për procedurën e prokurimit me objekt: Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin "Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10".

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

Ne bazë pikës 3, të nenit 114 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pikës 2 dhe 4 të nenit 100 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, **Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik ankimes "A&E Engineering" shpk** për procedurën e prokurimit me objekt: *"Lotit III, Mbikqyrja e punimeve për objektin "Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10"*, me nr. REF-52058-06-23-2025, zhvilluar nga AK, Bashkia Tiranë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ të pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimarrje për pjesën tjetër.

III.1. 5. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 32096 prot., datë 19.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2181/3 prot., datë 24.09.2025, ka përcjellë vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK, nga ku konstatohet se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën. Në kushtet kur nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një

procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-52046-06-23-2025, me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për 4 objekte të infrastrukturës pubike për vitin 2025”, me fond limit: 4,671,358.41 (katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2025, miratuar me VKB Nr.26, datë 03.04.2025, për një ndryshim në VKB Nr.131, Date 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025, **lotit III: REF-52058-06-23-2025**, Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rehabilitimi i Infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative Nr. 7+9+10”, me fond limit: 1,248,778.49 (një milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë dyzet e nëntë) lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 04.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK, duke e kualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro

